



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE

Tiranë me 07.03 .2020

**Njoftim mbi përfundimin e procedurës “Lëvizje paralele”
dhe zhvillimin e procedurës: “Pranim në shërbimin civil”, për pozicionin:
“2 (dy) Specialist/e, në Sektorin e Marrëdhënieve me Median, Publikun dhe Bibloteka”.**

Në zbatim të nenit 56, të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 22, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II-të, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, në përfundim të afatit kohor për dorëzimin e dokumentave personale (05.03.2020), të kandidatëve për konkurrim, me procedurën e lëvizjes paralele, asnjë kandidat nuk ka paraqitur dokumentat për konkurrim, për vendet e lirë të punës “2 (dy) Specialist/e, në Sektorin e Marrëdhënieve me Median, Publikun dhe Bibloteka”.

Njësia përgjegjëse pranë Gjykatës së Lartë (Sektori i Personelit dhe Shërbimeve) njofton se për vendet vakante “2 (dy) Specialist/e, në Sektorin e Marrëdhënieve me Median, Publikun dhe Bibloteka”, do të vazhdohet me procedurën: “Pranim në shërbimin civil”.

Kandidatët do të paraqesin dokumentat me procedurën e pranimit në shërbimin civil, deri me datën **11.03.2020** dhe do të marrin informacion në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure, duke filluar nga data **20.03.2020**.

NJËSIA PËRGJEGJËSE

SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE

